REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr.Br.No: 01-1392/3
Data/Datum/Date: 04/11/2026
Shtojca/Dodaci/Annex: -2-
PRISHTINË/A

Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Drejtësisë/MinistarsvoPravde/Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë -Ured Ministarke Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr.265 /2026
Datë:04.11.2026

Duke u mbështetur në nenet 9, 10 (paragrafët 1 dhe 2), dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, në përputhje me nenet 10 dhe 11 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.5) të Ligjit nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 354 (paragrafi 4, nënparagrafi 4.1), të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-118 dhe Ligjin nr. 08/L-102, dhe sipas nenit 53 (paragrafi 1) të Ligjit nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe në pajtim me nenin 6 të Rregullores (QRK) - nr. 08/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Zëvendëskryeministrja dhe Ministrja e Drejtësisë, nxjerr këtë:

V E N D I M
Për shfuqizimin e Vendimit nr. 251/2026 të datës 22.10.2026

1. SHFUQIZOHET Vendimi nr. 251/2026 i datës 22.10.2026 për emërimin e përmbaruesit privat z. Kushtrim Musa, zëvendësues i përmbaruesit privat z. Argjent Xheladini.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Departamenti për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika në Ministrinë e Drejtësisë.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Përmbaruesi privat z. Kushtrim Musa, me Vendimin nr. 251/2026 të datës 22.10.2026 është emëruar zëvendësues i përmbaruesit privat z. Argjent Xheladini. Me Vendimin DPSDPLS.nr.22/2026 të datës 21.10.2026 të Komisionit Disiplinor, përmbaruesi privat z. Argjent Xheladini, është shpallur përgjegjës për shkelje disiplinore sipas nenit 367 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjatë ndërmarrjes së veprimeve përmbarimore në lëndët P.nr. 1393/2026, P.nr. 2835/2026, P.nr. 1678/2026. P.nr. 2714/2026, P.nr. 2426/2026 dhe P.nr. 2834/2026.

Për përgjegjësinë disiplinore, përmbaruesit privat z. Argjent Xheladini, me Vendimin DPSDPLS.nr. 22/2026 të datës 21.10.2026 të Komisionit Disiplinor ndaj Përmbaruesit Privat i është shqiptuar masa disiplinore : "N*dalim i ushtrimit të profesionit në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajsh"*, e paraparë në nenin 368 (paragrafi 1, nënparagrafi 1.4) të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore.

Me Aktvendimin nr. AP.nr.797/2026 të datës 28.10.2026 të Gjykatës Administrative të Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm, aprovohet kërkesa e paditësit/propozuesit të sigurimit, përmbaruesit privat z. Argjent Xheladini me seli në Viti, Komuna e Gjilanit. Si rrjedhojë, pezullohet ekzekutimi i Vendimit DPSDPLS.nr. 22/2026 të datës 13.10.2026 i të padituruës/ kundërpropozueses Ministria e Drejtësisë, Departamenti për Profesione të Lira, Komisioni Disiplinor, deri në vendosjen përfundimtare të kësaj çështjeje në konflikt administrativ.

Andaj, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve ligjore brenda afatit ligjor, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Donika Gërvalla-Schwarz

Zëvendëskryeministre dhe Ministre e Drejtësisë

Vendimi u dërgohet:

- *Përmbaruesit privat zëvendësues z. Kushtrim Musa;*
- *Përmbaruesit privat të zëvendësuar z. Argjent Xheladini;*
- *Kabinetit të Zëvendëskryeministres dhe Ministres së Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika;*
- *Odës së Përmbaruesve Privatë;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*